



Partnerët do sigurojnë të dhëna dhe njohuri mbi titujt kombëtarë ekzekutive dhe procedurat në vendet e tyre respektive, si dhe do të analizojnë dhe identifikojnë pika kontestimi në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e titujve të huaj ekzekutivë. Partnerët do të synojnë të gjejnë zgjidhje për çështjet e kontestueshme dhe të paqarta, në mënyrë që të sjellin një qartësi më të mirë në këtë objekt studimi, me qëllimin final për të përmirësuar besimin reciprok ndërmjet shteteve anëtare. Hulumtimi do të drejtohet nga Universiteti i Mariborit, Fakulteti i Drejtësisë dhe Instituti i tij për të Drejtën Civile, të Krahastuar dhe Private Ndërkombëtare, i cili ka një eksperiencë të gjerë në projekte të ngjashme në fushën e ekzekutimit ndërkufitar.



INFORMACION

Projekti EU-En4s është i bashkë financuar nga Programi i Drejtësisë së BE-së (2014-2020). Qëllimi kryesor është promovimi i bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile, dhe të kontribuojë në zbatimin efektiv dhe koherent të instrumenteve të BE-së. Prioritet do i jepet përmirësimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, veçanërisht ato që rezultojnë nga çështjet ndërkufitare.

Për më shumë informacion

<https://www.pf.um.si/en/acj/projects/pr09-eu-en4s/>



Koordinator i projektit

prof. dr. Vesna Rijavec
vesna.rijavec@um.si




Fakulteti i Drejtësisë,
Universiteti i Mariborit

Instituti për të Drejtën Civile, të
Krahastuar dhe Private Ndërkombëtare.

Mladinska ulica 9
2000 Maribor
Slovenia



Faculty of Law



DIVERSITY OF ENFORCEMENT TITLES IN CROSS-BORDER DEBT COLLECTION IN THE EU

1ST JUNE 2019 - 31ST MAY 2021



Project EU-En4s - JUST-AG-2018/JUST-JCOO-AG-2018
Funded by the European Union's Justice Programme
(2014-2020)



IDEJA

Një ndër pengesat e shumta të hasura në ekzekutimin ndërkufitar të titujve ekzekutivë, ndoshta më e dukshmja është mungesa e besimit reciprok ndërmjet autoriteteve kombëtare të Shteteve të ndryshme Anëtare të BE-së. Autoritetet kombëtare i trajtojnë titujt ekzekutivë të shteteve të tjera anëtare me hezitim dhe mosbesim. Ky problem rëndohet nga diversiteti i titujve ekzekutivë në shtete të ndryshme anëtare, kryesisht struktura dhe efekti i tyre. Projekti synon të analizojë këto ndryshime dhe të gjurmtojë problemet e identifikuara, me qëllimin kryesor që të forcojë besimin reciprok.



OBJEKTIVAT

- › Kontribut në hulumtimin krahasues përsa i përket si koncepteve dogmatike, ashtu edhe atyre empirike të vendimeve gjyqësore, zgjidhjeve gjyqësore dhe dokumenteve autentikë, në mënyrë që të lehtësohet kuptimi më i saktë i rregullave të Shteteve Anëtare në lidhje me efektet e tyre juridike (si p.sh. res judicata), sidomos në rastet kur janë të përfshira disa shtete anëtare, duke ngritur kështu shqetësime ndërkufitare, veçanërisht nën dritën e regjimit të Rregullores Bruksel Ibis (e rishikuar) për njohjen dhe ekzekutimin;
- › Sqarimi i nocioneve të vështira, sikurse janë shkaku i padisë, papajtueshmëria e vendimeve gjyqësore dhe padi të lidhura;
- › Studim i avancuar mbi rolin e dokumenteve autentike, duke u fokusuar kryesisht në aktet noteriale që përbëjnë titull ekzekutiv;
- › Hartimi i manualeve ndihmuese për autoritetet kompetente për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, duke vënë në dispozicion një përmbledhje koncize të shembujve të titujve ekzekutivë dhe procedurave të huaja;
- › Përmirësim të Certifikatës së Zbatueshmërisë (urdhrit të ekzekutimit) në Shtetin Anëtar të origjinës;
- › Testim i argumenteve për shfuqizimin e rezervës (klauzolës) së rendit publik;
- › Ide për të ndihmuar në zbehjen, nëse jo në eliminimin, e pengesave terminologjike;
- › Prototip i mjeteve të teknologjisë së informacionit (emërim i përshtatshëm 'Enforcement Oracle' (Orakull i Zbatimit), ku profesionistët e së drejtës, mund të fitojnë njohuri në një mënyrë interaktive mbi titujt e huaj ekzekutivë.
- › Prospekte kërkimore të procedurave të ardhshme të automatizuara për ekzekutimin ndërkufitar.

GRUPI I PUNËS - SKUADRA

Ky projekt është projekti i pestë i Programit të Drejtësisë së BE-së i koordinuar në mënyrë të suksesshme nga Universiteti i Mariborit, Fakulteti i Drejtësisë, me koordinator prof. dr. Vesna Rijavec. Konsorciumi përfshin një rrjet të gjerë të universiteteve të njohura dhe institucioneve të tjera nga 13 shtete të ndryshme anëtare të BE-së dhe një vend kandidat, të përbërë nga partnerët e mëposhtëm:

- › Universiteti i Mariborit, Fakulteti i Drejtësisë, Slloveni
- › Universiteti Laibnic i Hanoverit, Gjermani
- › Universiteti Masarik, Fakulteti i Drejtësisë, Republika Çeke
- › Universiteti Mikolas Romeri, Lituani
- › Universiteti Portukalense, Portugali
- › Universiteti Britanik i Qipros UCLan
- › Universiteti i Gracit, Austri
- › Universiteti i Mastrihtit, Holandë
- › Universiteti i Rijekës, Kroaci
- › Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- › Universiteti i Vroklavës, Poloni
- › Universiteti i Upsalës, Suedi
- › Instituti për të Drejtën e Krahasuar në Fakultetin e Drejtësisë së Lubjanës, Slloveni
- › Shoqëria Boleo Global, Spanjë
- › CEPRIS, Slloveni
- › Dhoma e Noterisë, Slloveni